

## **BANKA E SHQIPËRISË**

### **Deklaratë për Shtyp**

#### **ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2006**

Nëntor 2006

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2006 rezultoi me një tepricë prej 45 milionë eurosh. Flukset hyrëse të kapitalit mundësuan në masën 70 për qind financimin e deficitit korent.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund t'i përgjithësojmë në:

- Aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente.
- Thellim i deficitit korent dhe i atij tregtar.
- Rënie e nivelit të huamarrjes private, në krahasim me një vit më parë.
- Rritje e pretendimeve të vendit ndaj jorezidentëve, e shprehur kryesisht në rritje të mjeteve financiare të zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë.
- Rritje e njëkohshme e mjeteve dhe e detyrimeve të huaja dhe rritje e rezervave valutore të autoritetit monetar.

## **I. Llogaria korente**

Transaksionet korente, të zhvilluara gjatë gjysmës së parë të vitit 2006, vlerësohen në rreth 3.2 miliardë euro ose 19 për qind më të larta se në vitin paraardhës. Shkëmbimet tregtare në mallra dhe shërbime kryesojnë vëllimin e transaksioneve korente të Shqipërisë me botën. Mëse 95 për qind e shpenzimeve korente, gjatë kësaj periudhe, kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh ndërkohë që, rreth 33 për qind e të ardhurave korente kanë hyrë në formën e transfertave korente. Shërbimet dhe eksportet e mallrave siguruan përkatësisht 38 për qind dhe 21 për qind të të ardhurave. Të ardhurat faktoriale neto u rritën me rreth 10 për qind dhe nuk kanë mundur të zbusin deficitin e lartë tregtar (mallra dhe shërbime). Si rezultat, llogaria korente u mbyll me një deficit prej 299 milionë eurosh, me rritje vjetore prej mëse 40 për qind.

### **I. 1. Tregtia e jashtme.**

Vëllimi i tregtisë së jashtme, importe plus eksporte, vlerësohet në rreth 1.4 miliardë euro, 20 për qind ky më i lartë kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Shkëmbimet tregtare në mallra përfaqësuan rreth 43 për qind të totalit të transaksioneve korente.

Shpenzimet për import mallrash shënuan afërsisht vlerën 1.1 miliardë euro ose 190 milionë euro më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2005. Të ardhurat nga eksporti i mallrave shënuan rreth 310 milionë euro.

Rritja më e shpejtë e shpenzimeve për importe kundrejt të ardhurave nga eksportet (respektivisht 21 për qind dhe 17 për qind), solli thellimin e mëtejshëm të deficitit tregtar, i cili rezultoi 23 për qind më i lartë se gjashtëmujori i parë i vitit 2005.

Sipas një analize në harmoni me sistemin e llogarive kombëtare, vendi ynë edhe gjatë këtij gjashtëmujori mbetet i orientuar drejt mallrave të ndërmjetëm, të cilët zënë afërsisht gjysmën e importeve tona (47 për qind), ndërkohë që mallrat kapitalë dhe ata të konsumit patën përkatësisht këto nivele përfaqësimi, 11 dhe 32 për qind.

Rritja më e ndjeshme në importe, gjatë këtij gjashtëmujori, ishte në karburante dhe në importe të energjisë elektrike (75 për qind). Kjo rritje është përforcuar gjithashtu edhe nga rritja e vazhdueshme e çmimeve të këtyre produkteve në tregjet botërore.

Në krahun e eksporteve, janë rritur ndjeshëm eksportet në minerale (kromi dhe hekuri) me tregje drejt Kinës dhe Maqedonisë.

Industria e përpunimit në vend vazhdon të jetë përcaktuese në marrëdhënie tona tregtare me botën. Importet e lëndës së parë përfaqësuan 15 për qind të totalit të tyre, ndërkohë që 70 për qind e eksporteve ishin kontribut i rieksperteve. Nivelet

e tyre të rritjes gjatë këtij gjashtëmujori ishin pothuajse të njëjta për të dyja kategoritë, rreth 11 përqind.

Pavarësisht rritjes së vazhdueshme të konkurrencës globale nga të tjera vende me kosto të ulët prodhimi (veçanërisht Kina), Lekut të fortë, si dhe ngadalësimit ekonomik të Italisë dhe Greqisë (tregjet kryesore të eksporteve tona), ka shenja përmirësimi në drejtim të industrisë së tekstileve dhe veshjeve të këmbëve. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2006, eksportet nga kjo industri kanë përmirësuar ecurinë e shfaqur vitin e kaluar. Treguesi i rritjes së eksportit të tekstileve këtë periudhë ishte 5 për qind kundrejt një rritjeje prej 0.06 për qind, të regjistruar një vit më parë. Po kështu, eksporti i këpucëve u rrit me 11 për qind krahasuar me rritjen prej 8 për qind të shfaqur në gjashtëmujorin e parë të vitit 2005.

Në shpërndarjen sipas partnerëve tregtarë, Bashkimi Evropian mban të njëjtat nivele përfaqësimi në transaksionet tona tregtare (64 për qind). Rreth 43 për qind e eksporteve tona janë të drejtuara drejt vendeve fqinje, Italia dhe Greqia, ndërkohë që 72 për qind e importeve vijnë nga po këto vende, duke i shndërruar ato në partneret kryesore të vendit tonë. Trendi rritës i importeve drejt vendeve të rajonit vazhdon të mbizotërojë edhe gjatë gjashtëmujorit të vitit 2006 (47 për qind), duke dalluar këtu përshpejtimin e shkëmbimeve tregtare në importe me Rumaninë, e cila u rendit e dyta ndër partnerët rajonalë. Në krahun tjetër, kjo periudhë u shoqërua me ngadalësimin e ritmeve të rritjes së eksporteve drejt këtyre tregjeve (5 për qind).

Në vlera absolute, rritja e importeve, nga viti në vit është shoqëruar me rritje modeste të eksporteve. Megjithatë, këtë vit ecuria në eksporte ka qenë më premtuese. Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet këtë periudhë arriti në 28 për qind nga 26 për qind në vitin 2005.

## **I. 2. Zhvillimet në zërat e tjerë të llogarisë korente.**

Tregtia në shërbime, me ritme rritëse përgjatë viteve të fundit, po shndërrohet gjithnjë e më shumë në një element të rëndësishëm të integritit për Shqipërinë. Transaksionet tregtare në shërbime arritën në 1.2 miliardë euro dhe vlerësohen 23 për qind më të larta, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2005. Llogaria e shërbimeve u mbyll me një bilanc negativ prej 37 milionë eurosh, i cili vlerësohet në rënie (rreth 23 për qind) kundrejt deficitit të regjistruar gjatë të njëjtës periudhë në vitin e kaluar. Zvogëlimi i deficitit tregtar në shërbime është shkaktuar kryesisht nga rritja e suficitit në shërbimet e udhëtimit si dhe nga ngushtimi i deficitit në kategorinë e shërbimeve të tjera.

Lëvizjet në llogarinë e shërbimeve ndikohen ndjeshëm nga zhvillimet në shërbime për “turizëm” (udhëtime), të cilat kontribuojnë në masë të konsiderueshme flukset hyrëse dhe dalëse të kësaj kategorie, përkatësisht me 70 dhe 62 për qind të totalit për këtë gjashtëmujor. Aktualisht, aktiviteti i turizmit vazhdon të përfaqësojë një nga burimet kryesore të të ardhurave në valutë për

ekonominë shqiptare. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, eksporti në turizëm, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2006 ka gjeneruar rreth 393 milionë euro flukse të ardhurash, një vlerë kjo rreth 27 për qind më e lartë se vlera e eksporteve të mallrave. Të ardhurat nga turizmi, për gjashtëmujorin, vlerësohet të jenë 23 për qind më të larta kundrejt të njëjtit hark kohor në vitin 2005, të ndikuara kryesisht nga rritja e fluksit të shtetasve të huaj dhe e emigrantëve që kanë vizituar vendin si dhe nga rritja e lehtë e koeficientëve vlerësues të shpenzimeve ditore. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2006, numri i shtetasve të huaj që kanë vizituar Shqipërinë është rritur me 17 për qind, në krahasim me të njëjtën periudhë në vitin e kaluar.

Aktiviteti i përshpejtuar vërehet në kahun e shpenzimeve për turizëm, të cilat vitet e fundit kanë shfaqur norma vjetore rritjeje më të larta. Rezidentët shqiptarë kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 367 milionë euro ose sa 85 për qind e totalit të dërgesave nga emigrantët. Rritja e shpenzimeve turistike jashtë ka ardhur si pasojë e rritjes prej 16 për qind të numrit të shqiptarëve që kanë udhëtuar jashtë vendit si dhe rritja e koeficientit të shpenzimeve ditore prej 11 për qind.

Zëri “shërbime të tjera”, ka rezultuar me një deficit prej 17 milionë eurosh, kundrejt deficitit prej 25 milionë eurosh në gjashtëmujorin e parë të vitit 2005. Zvogëlimi i tij ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së të ardhurave në shërbime kulturore dhe biznesi, dhe shërbime qeveritare.

Ekonomia shqiptare përfiton të ardhura në valutë prej punës së punonjësve sezonalë dhe investimeve të rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente, dhe njëkohësisht paguan interesat për borxhin e jashtëm. Rezultati neto i transaksioneve në të ardhura mbetet pozitiv edhe gjatë këtij gjashtëmujori dhe vlerësohet në rreth 91 milionë euro.

Të ardhurat nga puna, në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar, janë rritur me rreth 11 milionë euro duke arritur nivelin prej 54 milionë eurosh. Gjithashtu rritje kanë regjistruar të ardhurat nga interesat prej investimit të rezervës tonë valutore në institucione jorezidente si dhe të ardhurat nga interesat e mbledhur prej investimeve të portofolit të institucioneve rezidente jashtë.

Bilanci i transfertave korente, në fund të gjashtëmujorit të parë, u vlerësua në rreth 432 milionë euro, lehtësisht në rritje krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar. Peshën kryesore (rreth 86 për qind) të të ardhurave në këtë kategori vazhdojnë ta zënë prurjet e emigrantëve shqiptarë me banim jashtë. Gjatë kësaj periudhe këto transferta kanë arritur nivelin 432 milionë euro, duke qenë 12 për qind më të larta se ato të të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Këto transferta përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të deficitit tregtar (në mallra dhe shërbime) në mëse 50 për qind të tij. Prurjet nga emigrantët (432 milionë euro) janë shoqëruar edhe nga transferta shtetërore, kryesisht në formë të asistencës teknike (31 milionë euro), të cilat këtë periudhë vlerësohen rreth 41 për qind më të larta.

## **II. Llogaria kapitale dhe financiare**

Lëvizjet e kapitalit, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2006, regjistruan në një fluks neto prej rreth 208 milionë eurosh, dhe mundësuan në masën 70 për qind financimin e deficitit korent. Pas kësaj shifre pozitive, qëndrojnë transfertat kapitale hyrëse prej 76 milionë eurosh si dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare prej rreth 133 milionë eurosh. Pozicioni neto i llogarisë kapitale dhe financiare ka ruajtur të njëjtin nivel të periudhës korresponduese në vitin paraardhës.

Transfertat kapitale gjatë kësaj periudhe, u rritën me rreth 26 milionë euro ndërkohë që, bilanci pozitiv i llogarisë financiare vlerësohet në rënie ndaj një viti më parë (me rreth 26 milionë euro).

Pozicioni i llogarisë financiare këtë periudhë përkufizohet në rritje të detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën (me rreth 207 milionë euro) si dhe rritje të mjeteve tona jashtë (rreth 76 milionë euro). Megjithatë, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar, fluksi neto i detyrimeve financiare vlerësohet më i ulët, rreth 5 milionë usd, ndërkohë që pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës qëndrojnë në një nivel më të lartë (32 milionë euro).

Rritja e detyrimeve financiare ndaj botës, këtë gjashtëmujor, ka ardhur kryesisht prej flukseve hyrëse të kapitalit në formën e investimeve direkte dhe të huamarrjes me jashtë.

Investimet e huaja direkte vlerësohen në nivelin 125 milionë euro ose 17 për qind më të larta krahasuar me një vit më parë. Këto flukse kapitali janë shndërruar në një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare dhe në zhvillimet e transaksioneve kapitale e financiare të vendit.

Faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare kanë qenë lëvrimet e kredive afatgjata dhe atyre të buta nga jashtë, të cilat e kanë shtuar borxhin e jashtëm të Shqipërisë me 81 milionë euro. Në këtë borxh, përfshihet edhe përdorimi i huave dhe kredive në Fond, prej 2.9 milionë eurosh. Huamarrja shtetërore është rritur me rreth 19 milionë euro ndërkohë që, ndryshe nga ecuria gjatë dy viteve të fundit, ku është vënë re prania e sektorit privat në huamarrjen afatgjatë, këtë gjashtëmujor disbursimet e huave të këtij sektori kanë qenë më të ulëta (rreth 24 milionë euro më pak).

Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit dhe të interesit vlerësohen në rreth 39 milionë euro, të barasvlefshme me 13 për qind të eksportit të mallrave.

Nga ana tjetër, pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur me 32 milionë euro. Rritja e mjeteve është përcaktuar kryesisht nga rritje në mjetet e zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë, ndërkohë që investime portofoli të njësive rezidente jashtë, kanë ardhur në rënie.

Stoku i mjeteve financiare në formën e investimeve të portofolit, në fund të periudhës, kapi shumën 112.6 milionë euro, me një fluks gjashtëmujor në rënie

prej 1.6 milionë eurosh. Në përbërjen strukturore sipas monedhave 76 për qind i përkasin atyre në dollarë, 19 për qind në euro dhe 5 për qind në stërlinën angleze. Mjetet valutore të zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë, vlerësohen në rreth 536 milionë euro. Në përbërjen e depozitave të zotëruara nga sistemi bankar, dollari amerikan zë 54 për qind të tyre, ndërsa pjesa tjetër është në monedhën evropiane (41 për qind) dhe stërlina angleze (4 për qind). Gjithashtu, në rënie vlerësohen mjetet valutore *cash*. Në përbërjen strukturore sipas monedhave, mjetet valutore *cash* në dollarë amerikanë zinin 38 për qind dhe ato në euro 56 për qind, stërlina angleze 5 për qind.

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 45 milionë euro. Rezerva valutore e vlerësuar në 1.25 miliardë euro në fund të periudhës, qëndron në nivele të pranueshme duke mbuluar rreth 4.5 muaj importe.

**Bilanci i Pagesave**  
në milionë euro

	3m I '05	3m II '05	3m III '05	3m IV '05	3m I '06	3m II '06
Llogaria korente	(60.8)	(147.2)	(62.7)	(221.3)	(123.5)	(175.4)
Eksporti i mallrave	121.5	143.3	133.7	131.7	144.4	165.7
Importi i mallrave	(398.1)	(507.1)	(516.1)	(585.7)	(515.2)	(579.5)
Bilanci tregtar	(276.6)	(363.8)	(382.3)	(454.0)	(370.8)	(413.8)
Shërbimet: kredi	203.8	239.5	270.8	253.2	276.9	281.7
Shërbimet: debi	(227.9)	(263.3)	(309.9)	(306.6)	(303.8)	(291.7)
Të Ardhurat: kredi	39.8	38.0	53.5	47.1	58.5	51.4
Të Ardhurat: debi	(9.1)	(14.0)	(8.0)	(11.2)	(7.5)	(11.4)
Transferta private pa shpërblim	197.3	206.3	292.4	231.6	207.1	198.8
Transferta shtetërore pa shpërblim	11.8	10.1	20.8	18.6	16.2	9.7
Llogaria kapitale	35.5	14.6	25.0	24.1	36.1	39.5
Llogaria financiare	37.3	117.0	(19.1)	194.7	55.8	73.9
Investime direkte	56.9	50.3	53.0	63.9	56.8	68.6
Investime portofoli	(42.8)	(5.4)	40.9	5.4	4.6	(3.1)
Kapitale të tjera*	23.2	72.1	(113.1)	125.5	(5.6)	8.3
Gabime dhe harresa neto	(6.9)	17.0	85.7	82.6	44.3	91.5
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>9.7</b>	<b>1.4</b>	<b>33.7</b>	<b>80.1</b>	<b>15.6</b>	<b>29.5</b>
Rezervat dhe zëra të lidhur me to						
Mjetet e rezervës	(9.7)	(1.4)	(33.7)	(80.1)	(15.6)	(29.5)
Përdorim huash e kredish nga FMN	4.6	-	4.8	-	2.9	-
Për t'u mbajtur në vëmendje						
Ndryshimi total në rezerva	15.7	35.3	(30.1)	(68.3)	(8.2)	(6.5)
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	(25.4)	(36.7)	(3.6)	(11.8)	(7.4)	(23.0)

\*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.  
Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë.